

e organit të prokurorisë e ka lënë të lirë atë dhe ndërkohë ka caktuar si masë sigurimi personal “Detyrimin për t’u paraqitur një herë në dy javë para policisë gjyqësore.”

Ankuesi shkruan se arrestimi i tij nga Komisariati i Policisë Kukës është bërë në mënyrë të kundërligjshme sepse ai nuk e ka kryer veprën penale për të cilën u arrestua në flagrancë por gjithashtu edhe asnjë lloj vepre penale tjetër. Transportin e personave të huaj nga Tirana në Kukës e ka bërë në ushtrim të aktivitetit të ligjshëm si taksist për të cilin është i licensuar e i paguan shtetit detyrimet përkatëse dhe jo në kuadër të kryerjes së veprës penale për të cilën u arrestua.

Së bashku me ankesën ai na dërgoi edhe fotokopje të licencës nr. 38673, datë 04.11.2020 “Për transport udhëtarësh me taksist”, lëshuar nga Bashkia Tiranë, si dhe të faturës tatimore të datës 22.03.2022, e cila lidhet me rastin në fjalë.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e këtij rasti i kërkuam informacion Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

Drejtoria Vendore e Policisë (DVP) Kukës me shkresën nr. 1212/1 prot., datë 13.04.2022, na informoi se, në datën 22.03.2022, ora 18:00, shtetasi B.A. është arrestuar në flagrancë, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Ndhima për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal, pasi në datën 22.03.2022, ora 14:50, nga punonjësit e DVP Kukës, të vendosur në pikë kontrolli tek “Ura e Drinit të Zi”, Kukës, në mjetin e tij taksist janë gjetur 3 shtetas të huaj të parregullt.

Gjithashtu në këtë shkresë u informuam se nga veprimet e para hetimore në lidhje me këtë rast, është konkluduar se shtetasi B.A. ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal. Sipas DVP Kukës, referuar rasteve të tjera të konstatuara nga ky organ, në lidhje me transportin e shtetasve të huaj të parregullt, analog me këtë rast është proceduar me arrest.

Po ashtu, në këtë shkresë u informuam se ky fenomen është i njohur nga ana e shtetasve që punojnë si taksistë si dhe nga transporti publik. Qëllimi i shtetasve të huaj të parregullt që kapen në territorin e qarkut Kukës është kalimi i tyre në mënyrë të paligjshme në drejtim të Republikës së Kosovës dhe nga Kosova në shtetet e tjera. Bazuar në deklaratimet e tyre, ndihma që u jepet shtetasve të huaj të parregullt është transportimi i tyre sa më afër kufirit me Kosovën.

Përveç sa më sipër, në këtë shkresë u vumë në dijeni se i arrestuari është pyetur në prani të mbrojtësit të caktuar kryesisht dhe aktet procedurale i janë dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

Ndërsa nga përgjigjja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës me shkresën nr. 934/1 prot., datë 16.05.2022, rezulton se nga ana e këtij organi është regjistruar

procedimi penal nr. 121, i vitit 2022, në ngarkim të shtetasit B.A. për veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal dhe se Gjykata e Shkallës së Parë Kukës ka vendosur caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

Ndërkohë nga ana e këtij organi në datën 19.04.2022 është dërguar në Gjykatën e Shkallës së Parë Kukës kërkesa për pushimin e çështjes penale nr. 121/2022, e cila është në fazën e gjykimit.

Ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë Kukës me shkresën nr. 344/1 prot., datë 20.05.2022, sqaron se, me vendimin nr. 45, datë 24.03.2022 ka pranuar kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës dhe ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të shtetasit B.A., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal. Gjithashtu ndaj këtij shtetasi është caktuar masa e sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore një herë në dy javë, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

Përveç sa më sipër, në këtë shkresë u informuam se në datën 21.04.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës ka depozituar kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. 121, të vitit 2022, në ngarkimin të shtetasit B.A.. Kjo kërkesë i është nënshtruar procedurave të shortit elektronik dhe është në proces gjykimi.

Bashkë me informacionin gjykata na dërgoi edhe kopjen e vendimit gjyqësor nr. 45, datë 24.03.2022 të dhënë ndaj shtetasit B.A..

Në kuadër të hetimit administrativ, ankuesi B.A. në vijim na ka njoftuar se Gjykata e Shkallës së Parë Kukës ka pranuar kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës për pushimin e procedimit penal nr. 121, të vitit 2022, në ngarkim të tij dhe se ky vendim ka marrë formë të prerë.

Po gjatë vitit 2022, në institucionin tonë ka paraqitur një ankesë një tjetër shtetas, i cili ka ngritur të njëjtin shqetësim sa i përket veprimeve të kryera nga organi i prokurorisë dhe strukturat e Policisë së Shtetit. Konkretisht, me shkresat nr. K2/B9-3 prot., datë 26.09.2022, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës dhe nr. K2/B9-2 prot., datë 26.09.2022, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, ju kemi vënë në dijeni se në institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë shtetasi B.L. me banim në Tiranë. Ankuesi shkruan se ushtron aktivitetin e taksistit për të cilin është pajisur me licencën nr. 37273, datë 28.09.2021, me automjetin e tij tip veturë “Citroen”, me targë AF 841 T, me nr. taksie 860, lëshuar nga Bashkia Tiranë.

Në datën 04.09.2022, rreth orës 19:30, ai ka qenë në lëvizje në afërsi të mbikalimit tek ish sheshi “Shqiponja”, në Tiranë. Tre persona i kanë bërë shenjë duke ngritur dorën që të ndalonte. Ai ka ndaluar dhe meqënëse ata ju dukën se ishin të huaj i ka pyetur në gjuhën angleze se çfarë kërkonin. Ata nuk i kanë kthyer përgjigje por i kanë thënë vetëm Kukës. Ankuesi u ka ofruar shërbimin e kërkuar dhe kur ata kanë hipur në taksì u ka treguar me

shenjë taksimetrit e automjetit me qëllim që të kuptonin lidhur me pagesën që do të bënin në varësi të kilometrazhit. Kur ka shkuar në hyrje të qytetit Kukës, tek ura e lumit “Drini i Zi”, është ndaluar nga një patrullë policie. Patrulla e policisë e ka pyetur atë se ku do të shkonte. Ai i është përgjigjur se do të shkonte në qytetin e Kukësit. Punonjësit e policisë kanë tentuar që të komunikonin edhe me personat që ndodheshin në taksi por nuk janë marrë vesh. Pas kësaj punonjësit e policisë kanë bërë shoqërimin e ankuesit/taksistit dhe të personave që ishin brenda në taksi në Komisarariat e Policisë Kukës. Sapo kanë shkuar në komisarariat, nga policia është bërë verifikimi i dokumentacionit të ankuesit dhe ndërkohë i janë marrë deklaratime lidhur me transportin e shtetasve që kishte në makinë. Sipas policisë ka rezultuar se ata ishin shtetas sirianë.

Pasi i janë marrë deklaratimet nga policia gjyqësore ankuesit i është thënë se do të procedohej penalisht për veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”. Ndërkohë policia i ka sekuestruar automjetin e tij tip veturë “Citroen”, me targë AF 841 T, lejen e qarkullimit, lejen e drejtimit, certifikatën e pronësisë, policën e sigurimit dhe licencën e taksistit.

Gjithashtu ankuesi shkruan se, në datën 06.09.2022, i ka bërë kërkesë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës për kthimin e automjetit dhe të dokumentacionit përkatës të sekuestruar nga ana e policisë gjyqësore, por ato nuk i janë kthyer. Në datën 21.09.2022 ai është njoftuar nga avokati se organi i prokurorisë kishte filluar procedim penal ndaj tij për veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”. Në këtë ankesë shtetasi B.L. shkruan se fillimi i procedimit penal ndaj tij është bërë në mënyrë të kundërligjshme sepse ai nuk e ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet. Transportin e personave në fjalë nga Tirana në Kukës e ka bërë në ushtrim të aktivitetit të ligjshëm si taksist për të cilin i paguan shtetit detyrimet përkatëse dhe jo në kuadër të kryerjes së veprës penale për të cilën është proceduar penalisht. Sipas tij, referuar akteve normative në fuqi në vendin tonë, nuk ka asnjë pengesë ligjore që një taksist t’u ofrojë shërbimin taksi shtetasve të huaj që ndodhen në vendin tonë, apo të detyrojë atë që t’u kërkojë atyre dokumentet e identifikimit, pasaportën, nëse kanë vizë hyrje në Republikën e Shqipërisë, etj.

Përveç sa më sipër, ankuesi sqaron se për shkak të sekuestrimit të automjetit dhe dokumentacionit përkatës nga policia gjyqësore ka ngelur pa punë dhe kjo situatë i ka krijuar vështirësi ekonomike në familje sepse është i vetmi person që punon e siguron të ardhura. Sipas tij, nuk ka asnjë shkak ligjor për të bërë sekuestrimin e automjetit dhe të dokumentacionit të tij në këtë rast dhe për më tepër, heqja e sekuestrimit të vendosur nuk ndikon apo vë në rrezik hetimin e çështjes së filluar. Ndërkohë ai shkruan se, në rastin e tij nga organi i prokurorisë duhet të mbahet në konsideratë edhe personaliteti që ka, arsimi i lartë, është i padënuar penalisht, është kryefamiljar, etj.

Së bashku me ankesën shtetasi në fjalë na dërgoi edhe fotokopje të licencës nr. 38673, datë 04.11.2020 “Për transport udhëtarësh me taksi”, lëshuar nga Bashkia Tiranë, si dhe të dokumenteve të përshkruara më sipër.

Lidhur me këtë ankesë, në bazë të kërkesës tonë, Drejtoria Vendore e Policisë (DVP) Kukës me shkresën nr. 4636/1 prot., datë 13.10.2022, na informoi se në datën 04.09.2022, rreth orës 21:30, në vendin e quajtur “Ura e Drinit të Zi”, në hyrje të qytetit Kukës, shtetasi B.L. është kapur nga shërbimet e policisë duke transportuar me automjetin e tij taksi me targë AF 841 T, tre shtetas sirianë. Pas shoqërimit në organin e policisë është bërë procedimi i tij në gjendje të lirë për veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal, si dhe sekuestrimi me cilësinë e provës të automjetit të tij dhe të dokumentacionit përkatës. Materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

Ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës me shkresën nr. 1841/1 prot., datë 13.10.2022, na vuri në dijeni se, mbi bazën e materialit kallëzues të ardhur nga Komisariati i Policisë Kukës është bërë regjistrimi i procedimit penal nr. 418, i vitit 2022, për veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal, pa autor dhe çështja është në hetim e sipër. Deri më tani u janë marrë deklaratime shtetasve sirianë si persona që kanë dijeni për kryerjen e veprës penale, si dhe shtetasit B.L. si person nën hetim.

Sipas këtij organi, nga veprimet e para hetimore ka pasur dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se shtetasi B.L. po kryente aktivitetin e paligjshëm të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit, vepër kjo e përhapur kohët e fundit në vendin tonë dhe me rrezikshmëri të lartë shoqërore referuar marzheve të dënimit. Në funksion të këtij procedimi penal, nga ana e organit të prokurorisë janë duke u kryer disa veprime hetimore për zbardhjen e ngjarjes. Ndërmjet tyre është bërë këqyrja e mjetit të sekuestruar, e taksimetrit, veprime procedurale të cilat u bënë në praninë e shtetasit B.L.. Pas kryerjes së këtyre veprimeve, me urdhër të prokurorit të çështjes është bërë kthimi i automjetit të sekuestruar dhe të dokumentacionit përkatës pronarit.

Gjithashtu në këtë shkresë u informuam se pas përfundimit të të gjithë veprimeve hetimore, organi i prokurorisë do të konkludojë në lidhje me rezultatin e hetimeve dhe se personi i dyshuar do të informohet brenda afateve ligjore.

Pas analizimit me kujdes të ankesave të parashtruara më lart, është rasti që të sjellim në vëmendje se fillimi i procedimit penal është starti/pikënisja e veprimtarisë procedurale e organeve të ndjekjes penale. Ky moment lidhet me veprimtarinë procedurale-hetimore në drejtim të dokumentimit mbi baza ligjore të akteve dhe fakteve të çështjes të përcaktimit të fajësisë së autorëve të veprave penale. Instituti i fillimit të hetimeve, përkatësisht procedimit penal, ka një rëndësi të madhe shoqërore dhe juridike. Rëndësia shoqërore lidhet me faktin se përmes këtij instituti fillohet procedimi penal, i cili ka për qëllim luftën kundër kriminalitetit, mbrojtjen e interesave shoqërore të ligjshme të shtetasve të vet, duke përfshirë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, si dhe të vetë rendit juridik. Rëndësia juridike qëndron në faktin se nga momenti kur organi procedues vendos fillimin e procedimit, legjitimohet tërësisht që të ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme

procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale (KPP) që kanë të bëjnë me sqarimin dhe argumentimin e rrethanave të çështjes konkrete gjatë hetimeve. Sa më afër të jetë një vendimmarrje mbi fillimin e procedimit penal me vetë kohën e kryerjes së veprës penale, aq më efikase do të jetë veprimtaria e organeve të ndjekjes penale në drejtim të kërkimit, gjetjes, grumbullimit, zbulimit të fakteve, identifikimit të autorëve të veprave penale dhe vënien e tyre para përgjegjësisë penale. Përveç kësaj vendimmarrjeje duhet parë dhe vlerësuar garantimi i ligjshmërisë, pra që marrja e vendimit të jetë e bazuar, në funksion të respektimit të lirive dhe të të drejtave të shtetasve ndaj të cilëve organet e prokurorisë ndërmarrin veprime procedurale hetimore. Organet e prokurorisë janë të autorizuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe KPP-ja për ushtrimin e ndjekjes penale në bazë të inicimeve - kallëzimeve apo kryesisht, me qëllim mbrojtjen e vlerave juridike të shoqërisë tonë për shkak se fillimi i procedimit penal është në interes të publikut kur paraqitet nevoja për një gjë të tillë.

Synimi i çdo prokurori dhe organeve të tjera të lidhura me ndjekjen penale është qëndrimi për t'u shërbyer idealeve dhe detyrave të besuara, për punët dhe detyrat e tyre të përditshme, të ndërmarrin ndjekjet penale për zbardhjen e rasteve penale, që ndaj autorëve të veprave penale, në mënyrë të ligjshme, të aplikojnë dhe të zbatojnë dispozitat dhe sanksionet përkatëse ligjore për rastet konkrete. Sipas akteve normative në fuqi në vendin tonë gjatë procedimit penal, duhet të zbatohet parimi i ligjshmërisë i parashikuar në nenin 29/1 të Kushtetutës dhe nenin 2 të KPP, i cili nënkupton respektimin dhe zbatimin e detyrueshëm të normave ligjore.

Sipas nenit 24 të KPP-së, prokurori është i detyruar të fillojë ndjekjen penale kur ndaj personit apo personave të caktuar ekziston dyshimi i arsyeshëm, se ka kryer veprë penale. Kjo ndjekje ushtrohet kur ekzistojnë fakte dhe dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova. Në të kundërt, në kuadër të kallëzimit penal, duhet që të ndërmarrë veprime shtesë përmes policisë gjyqësore apo drejtpërdrejt për sigurimin e fakteve të nevojshme për të filluar një procedim të ligjshëm për të filluar ndjekjen penale, me qëllim për të evituar nxjerrjen e vendimeve të kundërligjshme, të cilat janë të panevojshme e të padëshirueshme dhe me pasoja për individin, organin procedues dhe opinionin publik.

Po ashtu sipas këtij neni, prokurori është i detyruar të ndërmarrë ndjekjen penale rreth fillimit të procedimit penal kur ndaj personit apo personave të caktuar ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra penale. Ndjekja sipas detyrës zyrtare-shtetërore ushtrohet kur ekzistojnë fakte dhe dyshimi i arsyeshëm apo i bazuar në prova se është kryer vepra penale.

Për fillimin e procedimit penal duhet të ekzistojnë bazat e mjaftueshme. Megjithatë, duke qenë se jemi në stadin e parë të fillimit të procedimit penal, bazë, e nevojshme është ekzistenca e të paktën dy kushteve:

- a -Ekzistenca e shkaqeve ligjore; dhe
- b- Të dhënat e mjaftueshme.

Në fazën e fillimit të procedimit penal, përkatësisht përpara fillimit, njoftimi për kryerjen e një vepre penale në përmbajtjen e tij shpesh, për shkak të bazës së pamjaftueshme të dyshimit për fillimin e tij, paraqitet nevoja për plotësime, sqarime, verifikime, si dhe për kryerjen e ndonjë veprimi të mundshëm hetimor, në mënyrë që prokurori të jetë sa më objektiv dhe i sigurt në vendimmarrjen e tij.

Ndërsa nga ana tjetër, bazat e mjaftueshme për fillimin e procedimit penal janë të lidhura pashmangshmërisht me vetë ekzistencën ose jo të veprës penale. Pra, me rrethanat që pasqyrohen në kallëzim apo në ankim, në sensin që këto rrethana, detyrimisht, duhet të verifikohen, paraprakisht, duke u vlerësuar/hetuar nëse përkojnë apo jo me realitetin objektiv apo kemi një shtrembërim të atyre rrethanave nga subjektet kallëzuese, apo kur faktit të pretenduar nuk i përgjigjet asnjëra nga veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal (KP).

Për të pasur baza të mjaftueshme për fillimin e procedimit penal, këto u referohen vetëm elementëve të anës objektive të figurës së veprës penale të treguar dhe vetëm si përjashtim, këto baza të mjaftueshme lidhen me subjektin konkret të veprës penale. Pra, duhet të kemi të dhëna të mjaftueshme se marrëdhëniet shoqërore janë dëmtuar apo cenuar si pasojë e një veprimi të ndërmarrë, apo mosveprimit, që duhej të ndërmerrej nga subjekti i figurës së veprës penale. Për të arritur në sqarimin e bazave të mjaftueshme për fillimin e procedimit penal është e nevojshme të sqarojmë se, vetë procedimi penal synon zbulimin e së vërtetës, duke zbatuar procedurën penale, si dhe parimet e objektivitetit dhe të paanshmërisë.

Evidentojmë faktin se ne nuk jemi kundër ndjekjes penale të personave që kryejnë aktivitet kriminal duke përfshirë edhe ata që kryejnë veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal, madje vlerësojmë punën e organit të prokurorisë dhe strukturave të Policisë së Shtetit në këtë drejtim. Por në rastet që personat e dyshuar si autorë të kësaj vepre penale janë taksistë të licensuar, çmojmë se për të filluar procedimin penal ndaj tyre, arrestuar, sekuestruar automjetet, etj., duhet që nga policia gjyqësore dhe organet e prokurorisë dyshimet të bazohen në prova.

Sikurse parashtrojnë ankuesit, transportin e personave në fjalë nga Tirana në Kukës e kanë bërë gjatë ushtrimit të aktivitetit të ligjshëm të tyre si taksistë për të cilin i paguajnë shtetit detyrimet përkatëse dhe jo në kuadër të kryerjes së veprës penale për të cilën janë proceduar penalisht. Pretendimet e tyre, se referuar akteve normative në fuqi në vendin tonë, nuk ka asnjë pengesë ligjore që një taksist t’u ofrojë shërbimin taksit shtetasve të huaj që ndodhen në vendin tonë, apo që nuk ka ndonjë parashikim që t’i detyrojë ata që t’u kërkojnë këtyre shtetasve dokumentet e identifikimit, pasaportën, nëse kanë vizë hyrje në Republikën e Shqipërisë, etj, në vlerësimin tonë qëndrojnë.

Fillimi i procedimit penal passjell pasoja për individin ndaj të cilit zhvillohen hetime, sikurse mund të jenë: caktimi/vendosja e masave të sigurisë duke i privuar lirinë siç ka

ndodhur në rastin e shtetasit B.A., si dhe sekuestrimin e automjeteve dhe të dokumentacionit përkatës siç është bërë në të dyja rastet në fjalë. Sekuestrimi i automjeteve dhe i dokumentacionit pasjellë pajosa ekonomike për personat ndaj të cilëve zhvillohen hetime për shkak se ata nuk mund të ushtrojnë aktivitetin ekonomik si taksistë. Por pasojat e ardhura këtyre shtetasve shtohen edhe me shpenzimet financiare që ata kanë bërë për shkak të pajtimit të avokatëve mbrojtës. Po ashtu, ndër pasojat e ardhura nuk mund të lemë pa përmendur edhe ato psikologjike e familjare.

Në rastet kur autorë të dyshuar të kësaj vepre penale janë taksistët nëpërmjet vënies në dispozicion ose përdorimit të mjeteve të transportit me të cilët ata ushtrojnë këtë aktivitet, dyshimet duhet të bazohen në prova konkrete. Në kryerjen e kësaj vepre penale është shumë e rëndësishme ana subjektive e figurës së veprës penale që është faji (në këtë lloj vepre penale, dashja) si dhe qëllimi spekulativ. Në të dyja rastet e shqyrtuara nga ana jonë, ne ju kërkuaam informacion se çfarë provash janë administruar nga policia gjyqësore apo organi juaj ndaj shtetasve B.A. dhe B.L. të cilat krijojnë dyshime të arsyeshme se ata kanë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 298/1 i KP dhe mbi bazën e të cilave është arrestuar në flagrancë shtetasi B.A. si dhe janë proceduar penalisht ky shtetas dhe shtetasi B.L.. Por, si nga ana e policisë ashtu edhe nga organi i prokurorisë u informuaam se provat e administruara ndaj tyre janë automjetet e sekuestruara dhe dokumentacioni përkatës, si dhe deklaratimet e marra shtetasve të huaj të kapur në automjetet taksistë. Ndërkohë nuk na informuat se çfarë kanë deklaruar këta shtetas në interes të hetimit dhe më konkretisht në ngarkim të personave të dyshuar si autorë të kësaj vepre penale. Po ashtu, nuk na informuat nëse ndërmjet personave të dyshuar dhe shtetasve të huaj ose personave të tretë/trafikanitë ka pasur biseda paraprake apo komunikime telefonike lidhur me kryerjen e kësaj vepre penale, etj, të cilat i implikojnë ata në veprimtari kriminale.

Sjellim në vëmendje se për zbatimin e masave të sigurimit personal (shtrënguese e ndaluese) duhet të mbahen parasysh kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 228 të KPP. Për vendosjen e tyre duhet që të plotësohen njëkohësisht tre kushtet e përgjithshme të parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni dhe të paktën një nga kushtet e veçanta të parashikuara në pikën 3 të tij, sipas të cilit:

“1. Askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova.

2. Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie të shuarjes së veprës penale, ose dënimit.

3. Masat e sigurimit personal vendosen:

a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit;

b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet;

c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet”.

Kjo dispozitë është interpretuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 7, datë 14.10.2011. Vlerësimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për konceptet “dyshim i arsyeshëm” dhe “rrezik”, si në lidhje me standardin e të provuarit të “dyshimit të arsyeshëm” dhe “rrezikut”, duhet të mbahen parasysh për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Sipas pikës 1 të nenit 228, koncepti “dyshim i arsyeshëm” nënkupton ekzistencën e provave, të elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit, të cilat i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë, që personi nën hetim të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Për rrjedhojë për caktimin e masës së sigurimit është e nevojshme që provat, direkte apo indirekte, të jenë të tilla që të bëjnë të duket e mundshme përgjegjësia eventuale e personit nën hetim, lidhur me akuzën për të cilën procedohet.

Në vlerësimin tonë, provat e përmendura në informacionin e dërguar nga ana juaj nuk krijojnë dyshime të bazuara për të fajësuar ankuesit. Nëse ata do ta kishin kryer këtë veprë, kuptohet që përfitimi financiar i konsiderueshëm duhet të ishte qëllimi i tyre, sepse në të kundërt nuk do të kishin arsye për të rrezikuar lirinë e tyre për një pagesë si për udhëtarët e tjerë të zakonshëm apo “të rregullt”. Në fakt, për asnjërin prej të dy ankuesve B.A. dhe B.L. nuk na informuat se pagesat e kryera nga shtetasit e huaj ishin të ndryshme apo të larta duke i krahasuar me pagesën normale të transportit me taksë në itinerarin Tiranë-Kukës.

Fakti që ndaj shtetasit B.A. mbi bazën e kërkesës së organit të prokurorisë, Gjykata e Shkallës së Parë Kukës ka vendosur pushimin e procedimit penal konfirmon pretendimet e tij se ky shtetas nuk e ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 298/1 të KP për të cilën u arrestua në flagrancë nga policia.

Gjithashtu në përgjigjet e dërguara, nuk ishte shterues informacioni se cilin nga kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit 228 të KPP plotësonte shtetasi Brahim Balla që ndaj tij të zbatohet masa e sigurimit personal (masë shtrënguese).

Ndërkohë në vlerësojmë se në të tilla raste, kur personat e dyshuar si autorë të kësaj vepre penale janë taksistë, veprimet e para hetimore, sikurse janë verifikimi i komunikimeve telefonike, këqyrja e aparateve të telefonëve dhe e automjeteve, etj., duhet të kryhen sa më shpejtë të jetë e mundur dhe jo pas disa muajve, sikurse ka ndodhur në fakt, duke i bërë këto veprime jo efektive dhe nga ana tjetër duke pasqyruar pasoja juridike, ekonomike dhe psikologjike për shtetasit në fjalë.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, lind nevoja e një reagimi nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, për të ndryshuar praktikën e deritanishme dhe për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të

drejtave të shtetasve të dyshuar si autorë të veprës penale të parashikuar nga neni 298/1 i KP dhe në veçanti taksistëve.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË :

1. Ushtrimin e ndjekjes penale për veprën penale “Ndihma për kalimin e paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal, ndaj taksistëve nëpërmjet vënies në dispozicion ose përdorimit të mjeteve të transportit, vetëm në ato raste kur ndaj tyre krijohen dyshime të arsyeshme dhe të bazuara në prova se ata e kanë kryer atë.

2. Në rastet e aplikimit të masave shtrënguese të sigurimit personal dhe të sekuestrimit të automjeteve e të dokumentacionit përkatës shtetasve të dyshuar si autorë të kësaj vepre penale, veprimet hetimore, sikurse janë verifikimi i komunikimeve telefonike, këqyrja e automjeteve, e dokumentacionit, etj., të kryhen brenda një kohe sa më të shpejtë dhe të arsyeshme.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi